



## Sqarim i ZRRE-së për akuzat e pabaza në lidhje me vendimin e fundit nga shqyrtimi i jashtëzakonshëm tarifor

Për informim sa më të mirë të opinionit publik, Bordi i ZRRE-se ka për obligim të përgjigjet në një mënyrë të thjeshtë dhe lehtë të kuptueshme për të gjitha çështjet që janë në interes të përgjithshëm. Bordi i ZRRE-së i kryen detyrat dhe funksionon në përputhje të plotë me Ligjin për Rregulatorin e Energjisë të Republikës së Kosovës, ku përfshihet edhe legjislacioni sekondar që nxirret nga ZRRE përmes Bordit të saj.

Bordi i ZRRE-së i kryen detyrat në përputhje të plotë me ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës dhe Rregullat të cilat nxirren nga ZRRE në përputhshmëri të plotë me ato ligje.

**Të gjitha Vendimet e Bordit të ZRRE-së janë marr në mënyrë transparente dhe janë të publikuar, si dhe të gjitha kërkesat për sqarime janë shpjeguar në hollësi.**

ZRRE gjithmonë mirëpret interesimin e palëve të interesit dhe opinionit të gjerë. Me këtë qëllim ZRRE informon të gjitha palët se gjatë përcaktimit të tarifave Bordi i ZRRE-së nuk ka shkelur asnjë Rregullore apo Ligj të sektorit të energjisë ose ndonjë ligj tjetër.

Bordi i ZRRE-së është munduar të jap çdo shpjegim mbi legjislacionin në fuqi dhe të përgjigjet në çdo pyetje rreth ligjshmërisë së Vendimeve të tij. Gjatë gjithë periudhës së konsultimeve publike si dhe pas marrjes së Vendimit në mënyrë të hapur ZRRE ka dhënë përgjigje për të gjitha shkeljet e pretenduara nga organizatat e ndryshme. Për më tepër pas çdo shpjegimi është kuptuar edhe nga vet organizatat se shpjegimet janë të mjaftueshme për shkak se në fund peticioni u organizua për pretendime të shkeljeve të reja, apo më saktësisht nenit 1.4.1.

Të paktën mund të pranohet fakti se deri tani, edhe pse ZRRE është akuzuar për shkelje të ndryshme, pas shpjegimeve përkatëse nga ZRRE vet këto organizata kanë kuptuar se Bordi nuk ka shkelur asnjë Rregullore apo Ligj, dhe në fund kanë vendosur të bëjnë akuzën e fundit për shkelje të Nenin 1.4. Në asnjë nga shkresat e mëhershme nuk ka pas kontestim të këtij nenit dhe nuk është kërkuar sqarim nga ZRRE. Neni 1.4.1 nuk ka të bëj fare me shqyrtim të jashtëzakonshëm apo me rritje të tarifave, dhe është duke u zbatuar plotësisht.

**Peticioni është organizuar me pretendime të pabazuara për shkelje të ligjit nga ana e Bordit të ZRRE-së**

Baza ligjore e këtij peticioni theksohet të jetë nenii 1.4 i Ligjit të Rregulatorit të Energjisë. Neni 1.4.1 i Ligjit të Rregulatorit të Energjisë është jo relevant për përcaktimin e kostove të furnizimit me energji elektrike. Neni i cekur është i lidhur me strukturën tarifore të konsumatorëve fundor, dhe ky nen përcakton se gjatë zbatimit të përgjegjësive të saj, ZRRE po ashtu merr parasysh nevojën për zbatimin e



masave të duhura për përforcimin e kohezionit social dhe ekonomik në Kosovë. Masat të cilat ligji lejon të bëhen nga ZRRE janë vendosur përmes tarifës më blloqe, në mënyrë që të sigurojmë se të paktën shtresa me e rezikuar nga varfëria e ka të përballueshme një sasi të domosdoshme të energjisë.

Të gjitha çështjet tjera sociale, sipas ligjeve në fuqi nuk janë kompetence e ZRRE-së. I vetmi mekanizëm sipas këtij ligji është masa për vendosje të strukturës tarifore në atë mënyrë që përforcon kohezionin social.

Përmes petitionit, kërkohet shkarkimi i Bordit të ZRRE-së për shkelje të Ligjit për mos zbatim të Nenit 1.4.1 duke pasur parasysh, se edhe Kuvendi i Kosovës ka lëshuar rekomandimet e tyre rreth strukturës tarifore dhe pas pranimit të këtyre rekomandimeve ZRRE ka hapur konsultime publike pikërisht për këtë strukturë tarifore me blloqe dhe ka marrë Vendim që struktura të mbetët e njëjtë për shkak të mbrojtjes së konsumatorëve në nevojë. Sidoqoftë duhet të kuptohet se Neni 1.4 nuk ka të bëj fare me shqyrtim të jashtëzakonshëm apo me rritje të tarifave.

***Organizatorët e petitionit kanë keq interpretuar Legjislacionin në fuqi për ndryshimin e Vendimeve të Rregullatorit. Të vetmet institucione që kanë fuqi të ndryshojnë Vendimet e ZRRE-së janë organet e gjyqësorit***

Si në shumë vende tjera ku kërkohet të ndërtohet një Rregulator i fuqishëm, procedurat e shkarkimit të Bordeve janë të kufizuara në çështje të shkeljeve ligjore. Pavarësisht asaj se a pajtohen organizatat që kanë organizuar nënshkrimin e petitionit, me këto sqarime të ZRRE-së mbi Rregullat dhe Ligjet e sektorit të Energjisë, duam të sqarojmë se është gabim të kërkohet ndërhyrje e Kuvendit të Kosovës por duhet të ndiqen procedurat e nevojshme dhe të hapura për të gjithë përmes sistemit gjyqësor. Ligji në fuqi nuk parashev procedura për shkarkimin e anëtarëve të Bordit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës kur Bordi i ZRRE rrit tarifat e energjisë elektrike. Procedurat e shkarkimit të Bordeve janë të kufizuara në çështje të shkeljeve ligjore që së pari duhet të konstatohen nga Gjykata kompetente.

Nevoja për një Rregulator të pavarur vjen si rezultat i ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Kosovës, dhe të kërkohet ndërhyrje e Kuvendit të Kosovës për të ndikuar mbi Vendimet e Rregullatorit shkon në kundërshtim me parimet e Ligjeve të cilat janë në fuqi. Këto Ligje janë pjesë e reformave të cilat po bëhen nga të gjitha institucionet shtetërore për të përafruar Legjislacionin e Kosovës me Legjislacionin Evropian dhe duke pasur parasysh synimet e shtetit tonë për integrim në Bashkimin Evropian, është në kundërshtim edhe me parimet e Direktivave më të reja të Bashkësisë Evropiane, të cilat pikërisht synojnë të kufizojnë ndikimet politike në Rregulatorët e pavarur.

Gjithashtu për shkak të ligjeve në fuqi nuk mund të akuzohet Bordi i ZRRE-së, se kinse po gabon në marrjen e Vendimeve në kohën kur sipas tyre ka vakum politik, sepse pikërisht për të evituar probleme të natyrave politike, ZRRE ka detyrë të merr Vendime sipas ligjeve në fuqi pa u kufizuar fare në ngjarjet politike. Pikërisht për këtë arsyen janë paraparë që apelet e Vendimeve të Bordit të ZRRE-së të bëhen përmes Gjykatave kompetente e jo Kuvendit të Kosovës. Pa tentuar të minimizojmë punën mbikëqyrëse të Kuvendit të Kosovës, duhet të kuptohet se Ligji në fuqi nuk parashev dispozita ndëshkuese që mund të vendosen nga Kuvendi i Kosovës mbi ZRRE-në për shkak të Vendimeve që i merr Bordi i ZRRE-së.



Sipas ligjit në fuqi anëtarët e Bordit janë të detyruar të punojnë në mënyrë të pavarur dhe sipas dëshmive të cilat prezantohen para tyre. Për këtë arsyе Vendimet e Bordit të ZRRE-së mund të apelohen në Gjykatën kompetente nëse ndonjë person mendon se u janë shkelur të drejtat. Nëse ZRRE ka marrë Vendim të cilin Gjykata e refuzon, atëherë ZRRE është e detyruar të merr masa për të përm bushur obligimet nga Vendimet e Gjykatës.

**ZRRE nuk ka bërë shkelje as gjatë shqyrtimit të parë, apo më saktësisht kur është marrë vendimi për shtrenjtim prej 4.57%.**

ZRRE është krijuar të shërbej në interes të të gjithë konsumatorëve dhe pikërisht për këtë shkak ka analizuar në detaje Vendimin e mëparshëm për rritje prej 4.57%, dhe arsyet e vonesave në marrjen e Vendimeve kanë qenë dhe mbesin shumë të thjeshta për tu kuptuar.

Në fillim të shqyrtimit të parë të rregullt tarifor, pra në vitin 2013, kemi pranuar kërkesa të cilat kanë qenë shumë më të larta se pritet e ZRRE-së, dhe pas pranimit të këtyre kërkesave ZRRE është detyruar të analizoj çdo kosto të këtyre kërkesave në detaje, me synim të gjetjes së zgjidhjeve më optimale për sistemin, në mënyrë që të kemi kosto më të ulëta të sistemit energjetik dhe rrjedhimisht edhe tarifa më të ulëta. Pavarësisht pretendimeve se ZRRE ka shtyrë aprovimin për shkak të zgjedhjeve në këtë kohë, e vërteta është se Bordi i ZRRE-së ka zgjatur procesin e aprovimit të të hyrave te lejuara për kërkesat e vitit 2013, gjë që i lejohet sipas Rregullave në fuqi, për arsyе se kërkesat kanë qenë shumë më të mëdha se sa parashikimet që janë vendosur qysh në vitin 2012 kur edhe është marrë Vendimi për tarifa 5 vjeçare. Kërkesat e para të licencuarve për rritje të të Hyrave të lejuara kanë qenë mbi 20%, dhe skenari i ngritjes së tarifave për një ndryshim prej 20% ka qenë i papranueshëm për ZRRE. Pas bisedimeve me të gjithë të licencuarit edhe falë bashkëpunimit me të gjitha palët, ZRRE ka arritur të planifikojë një gjenerim më të madh të njësive të Kosovës A, në mënyrë që të kemi import më të ulët, dhe kjo ka lejuar të merret Vendimi për një rritje prej vetëm 4.57%.

**Secili person që konstaton se anëtarët e Bordit të ZRRE-së kanë bërë shkelje të dispozitave ligjore mund të kërkoj shkarkimin e anëtarëve të Bordit**

Ligji e precizon shumë qartë në Nenin 24 se "**kuorumi për seancat e Bordit është tre (3) anëtarë. Seancat e Bordit mund të mbahen nëse ekziston kuorumi, pavarësisht nëse ka një apo dy pozita të lira në Bord.**"

ZRRE është institucion i pavarur shtetëror i krijuar pikërisht për të ndarë ndikimet politike nga gjithë sektori energetik në mënyrë që të krijohet një treg i qëndrueshëm i energjisë përmes marrjes së Vendimeve, pavarësisht situatave politike në vend. Gjatë vendimmarjes, ZRRE angazhon shume ekspert dhe profesionist të këtyre fushave, si vendorë ashtu edhe të jashtëm. Të gjitha Vendimet e ZRRE-së mund të kufizohen apo anulohen tërësisht nga Gjykata kompetente. Është shumë joserioze të akuzohen anëtarët e Bordit të ZRRE-së për ndikime politike vetëm për arsyje të kohës së emërimit të tyre në Kuvendin e Kosovës. Vetëm sa për informatë përbërja e tanishme e Bordit ka marrë Vendime në bazë të Rregullave të cilat janë miratuar nga një përbërje krejtësisht tjetër e Bordit paraprak, i cili edhe në atë kohë ka qenë në përbërje prej vetëm tre anëtarëve.



Sipas Ligjit të Regulatorit të Energjisë, secili person që konstaton se një anëtar Bordi ka kryer ndonjë prej shkeljeve, sipas dispozitive relevante të ligjit dhe kërkon shkarkimin e tij/saj, duhet t'ia parashtrojë rastin Gjykatës kompetente për të zgjidhur çështjen. Në rast se gjykata kompetente konstaton se ka dëshmi thelbësore që mbështesin pretendimin e tillë, gjykata kompetente e Kosovës i propozon Kuvendi të Kosovës shkarkimin e anëtarit të Bordit.

***Nëse organizatat e ndryshme do të kishin organizuar një peticion i cili përban vetëm dy pikat: për heqjen e tantiemës dhe TVSH-së nga sistemi energjetik, shumë anëtarë të ZRRE-së do të kishin nënshkruar këtë peticion me dëshirë.***

ZRRE punon në mënyrë të vazhdueshme në kontrollin e kostove të sektorit energjetik dhe çdo lehtësim në drejtimin e mbajtjes së kostove më të ulëta për sisteminës prioritet i ZRRE-së në këtë kohë kur jemi duke kaluar nëpër një fazë të vështirë të përmirësimit të sektorit energjetik. ZRRE ka qenë një ndër institucionet e vetme e cila e ka kundërshtuar vendosjen e tantiemës apo më saktësisht rritjen e saj prej 0.27 euro në 3 euro. ZRRE është njëra ndër institucionet më të zëshme në takimet e ndryshme ku kërkon të gjejë lehtësira financiare për sektorin e Energjisë. ZRRE po ashtu ka mbajtur shumë takime me Qeverinë për të iniciuar këtë proces, dhe shumë takime informuese me deputetët e Kuvendit të Kosovës për të shpjeguar ndikimet e tantiemës në një treg të rregulluar të energjisë elektrike. Siç u tha më herët, nga Vendimet e Bordit qysh në vitin 2012 është parashikuar një rritje në vitin 2013, dhe gjatë gjithë kësaj kohe ZRRE është munduar të gjej mënyra për të bindur institucionet tjera shtetërore për lehtësira financiare për gjithë sektorin.